



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



01 Nr. 024-23
Me datë 31-08-2023
Mamushë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 45, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/07 maj 2013”, konform nenit 6, të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr. 04/2020 Kujdesi Parësor Shëndetësor dhe nenit 43, Rregulloren përcaktimin e llojit të shkeljeve etike dhe procedurat e mbikqyrjes etike 17/2019 i datës 19.02.2019 lidhur me nenin 44 dhe nenin 45, të Statutit të Komunës së Mamushës i datës 01.12.2008, Kuvendi i Komunës në Mamushë në mbledhjen e mbajtur me datën 30.06.2023 miratoi;

VENDIM

Për Rregullore për Organizimin e Mbrendshëm të Qendrës Kryesore Familjare në Mamushë

NENI I

Miratohet: Për Rregullore për Organizimin e Mbrendshëm të Qendrës Kryesore Familjare në Mamushë, në bazë rekomandimeve të dhëna nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë me anë të shkresës për shqyrtim të ligjshmërisë 05-4962, ku me anë të së cilës janë larguar që të gjithë nenet e cekura në këtë Shkresë.

NENI II

Qëllimi i kësaj rregullore të përmendur në NENIN I të këtij vendimi ka për Qëllimi përcaktimin e rregullave lidhur me: Organizimin dhe funksionimin e brendshëm të QKMF-së, ndarjen nëpër njësi të brendshme Teknike (këtej e tutje: struktura), udhëheqjen e tyre, fushëveprimin dhe kompetencat e tyre dhe marrëdhëniet reciproke në mes tyre;

NENI III

Pjesë Përbërëse e këtij vendimi është Draft Rregullore për Organizimin e Mbrendshëm të Qendrës Kryesore Familjare në Mamushë

NENI IV

Për zbatimin e kësaj rregullore detyrohet Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

NENI V

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë Përgjegjëse MAPL dhe Publikimit në WEP FAQE.

Me këtë njoftohen
QKMF
DShMS
Arkivi

Kryesuesi i Kuvendit të Mamushës

